SHOQËRIA TREGTARE "THORENEKS" SHPK KORCË

---

VITI 2005

Muaji Tetor Data 30 ora 11.oo

**VENDIM Nr.2**

Sot, më datë 30.10.2005, ora 11.oo, në selinë e shoqërisë në qytetin e Korçës, km 1 i Rrugës Korçë-Bilisht, u mblodh Asambleja e Ortakëve të shoqërisë tregtare "THORENEKS" SHPK me prezencën e të dy ortakëve: z. Thoma Xega dhe z. Aurel Xega, të cilët zotërojnë 100 % të kapitalit themeltar.
Mbledhja e Asamblesë procedoi me këtë rend dite :

1. Shqyrtim i akteve dhe raportit të vlerësimit të bërë nga eksperti kontabël i autorizuar z. Vangjush Postoli për zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me anë të kontributeve në natyrë.

2. Ndryshimet e mundshme në Statutin e shoqërisë për shkak të zmadhimit të kapitalit themeltar, përsa i përket kapitalit themeltar, pjesëve zotëruese të tij prej ortakëve.

Asambleja e ortakëve të shoqërisë shqyrtoi veçmas pikat e rendit të ditës dhe,

**Konstatoi:**

se gjëndja financiaro-ekonomike është në tregues të mire, aktivet e qëndrueshme të shoqërisë janë zgjeruar ndjeshëm, raporti i vlerësimit i ekspertit kontabël të autorizuar i përgjigjet realitetit dhe mbështetur në legjislacionin Për Shoqëritë Tregtare dhe në Statutin e shoqërisë, me unanimitet në votim,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar z.Vangjush Postoli për vlerësimin e kontributeve në natyrë me të cilët do të zmadhohet kapitali themeltar
2. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me anë të kontributeve në natyrë (aktive të qëndrueshme-të trupëzuara të shoqërisë) në masën e 4.138.421 (katërmilion e njëqind e tridhjetë e tetëmijë e katërqint e njëzetë e një) lekëve, që së bashku me kapitalin themeltar ekzistues prej 22.738.200 lekë (njëzetë e dymilioneshtatëqindetridhjetëetetëmijëedyqind) bëhet në vlerën e 26.876.621 (njëzetë e gjatëmilion e tetëqint e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqindenjëzetenjë) lekëve
3. Ortakët e shoqërisë ruajnë në kapitalin themeltar raportin ekzistues të para zmadhimit të këtij kapitali, përkatësisht ortaku Thoma Xega zotëron 55 %

të kapitalit themeltar dhe ortaku Aurel Xega zotëron 45 % të kapitalit themeltar.

4. Bërjen e këtyre ndryshimeve në Statutin e shoqërisë:

a) Neni 13 i Statutit të shoqërisë ndryshohet si vijon :
Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën e 26.876.621 (njëzetë e gjatë milion e tetëqint e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e njëzet e një) lekëve dhe përbëhet nga:
Kontributet në natyrë në vlerën e 26.776.621 lekëve
Kontribute në para në vlerën e 100.000 lekëve

b) Pas nenit 13 të Statutit shtohet Neni 13/a me këtë përmbajtje:
Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë është i ndarë si vijon:
1. z. Thoma Xega zotëron 55 % të kuoatve ose 14.782.141,55 lekë.
2. z. Aurel Xega zotëron 45 % të kuotave ose 12.094.479,45 lekë

5. Për depozitimin e vendimit Nr. 2 dt. 30.10.2005 të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë pranë Rregjistrit Tregtar Tiranë ngarkohen administratori i shoqërisë.

**Asambleja e Ortakëve të shoqërisë tregtare "THORENEKS" SHPK**

**Thoma XEGA** **Aurel XEGA**

Thoma Xega Aurel Xega

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË KORÇË
Nr. 2534 Rep.
Nr. 1385 Kol.

**VËRTETIM**

Sot, më datë 12.11. 2005, ditën e Shtunë, para meje noterit Lhuareta Maco anëtar i Dhomës së Noterisë Korçë, u paraqitën personalisht : 1. z. Thoma Xega, i biri i Jorgjit, i dt.lindjes 23.01.1967, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me Nr. 1811477, banues në Mborje- Korçë, dhe, 2. z. Aurel Xega, i biri i Jorgjit, i dt.lindjes 03.02.1969, shtetas shqiptar, mbajtës i pasaportës me Nr. Z 0166937, banues në Mborje-Korçë. Të dy personat madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, të cilët me cilësinë e ortakëve të shoqërisë tregtare "THORENEKS" SHPK më deklaruan se jashtë kësaj zyre është përpiluar me vullnetin e tyre të lirë e të plotë **Vendimi** i asamblesë së Ortakëve Nr. 2, dt. 30.10.2005, të cilën ata e nënshkruajnë përpara meje dhe unë noteri sipas ligjit vërtetoj nënshkrimet e tyre.

**NOTERI**

Lhuareta Maco

PULLE TAKSE
100 LEKE
R. SHQIPERISE